

Ju lutemi që, para se të vendosni për blerjen e prodhimeve tona, mirë ta lexoni këtë dokument, të shqyrtoni situatën dhe të vlerësoni se a i plotësoni kushtet për montim.

Të gjitha devijimet më vonë gjatë shfrytëzimit shkaktojnë:

- shpenzime të mëdha për servisim të jashtëzakonshëm
- shkurtrim të dukshëm të jetëgjatësisë punuese të kaldajës
- djegje të dobët të peletit
- konsum të rritur të peletit

Po qe se keni çfarëdo pyetje tjera shtesë, korigjim të vogël të dimensioneve të hapësirës, ventilimin apo oxhakun, Ju lutemi të kontaktoni shërbimin servisor apo teknikun tonë: **+ 381 31 783 927**.

Nëse i plotësoni këto kushte, vetes ia siguron shfrytëzimin afatëgjatë, ekonomik dhe të sigurtë, të prodhimeve tona.

## 1. Distanca minimale e ansoreve të kaldajës nga muri

- ana e majtë: 65cm
- ana e djathtë: 50cm
- ana e prapme: 40cm
- ana e përparme: 100cm
- artësia e dhomës (hapësirës): 60cm nga maja e kaldajës

Kjo është e domosdoshme për të qenë në gjendje që servisuari të bëjë servisimin vjetor apo shpejt të sanojë prishjen eventuale në kaldajë, si dhe ju të keni mundësinë që lehtë dhe papengueshëm të mirëmbani kaldajën dhe gypin tymues.

Në të kundërtën, do të vinim në situatë ku nuk mund të bëjmë asnjë intervenim.


## 2. Për punë efikase, kaldaja duhet të jetë e vendosur në dhomë(hapësirë) të ajrosur

Vrima për përcjelljen e ajrit të pastër duhet të jetë në pjesën e poshtme të dhomës, 30cm mbi dysheme afër kaldajës, madhësisë minimale 100cm<sup>2</sup>. Nevojitet vrima ventiluese për largimin e ajrit të ndotur(pluhurit nga kaldaja dhe hirit) në pjesën e sipërme të dhomës, 20-30cm nën tavan, madhësisë minimale 150cm<sup>2</sup>.

Shkaku i mundësisë, për shkak të gulfatjes(asfiksimi) të kaldajës të shkaktuar nga mosmirëmbajtja e rregullët të gypit të tymit dhe oxhakut, për t'u shfaqur koncentrimi i madh i tymit në dhomë, **është shumë e rëndësishme të ekzistojë vrima ventiluese për largimin e ajrit të ndotur.**

Firma KEPO prodhon qyngë me diameter Ø120mm me roseta dekorative dhe fund rrjetor, të cilin mund ta montoni në vrimin ventiluese.

Këto vrima duhet të jenë të punuara në atë mënyrë që kurrë të mos vijë deri tek mbyllja e tyre.



### 3. Për largimin(thithjen) e gazrave tymuese përdorë vetëm gypa tymi(qynga) Ø80, Ø100, Ø120 me gomë silikoni

Sasia maksimale e qyngave që lidhin kaldajën me oxhakun janë:

- T elementi – 1 copë
- Qynga të drejta nga 1000mm deri në 500mm – maksimalisht 3m
- Bryla 90° - 1deri në 2 copë

Në rast të përdorimit të të dy brylave 90°, gjatësia e qyngës së drejt mund të jetë maksimalisht 2m.

Qyngat e vendosura horizontalisht nuk guxojnë të jenë më të gjata se 1m, me ramje të detyrueshme në kaldajë prej 3-5%.

Në fund të instalimit të qyngave në kaldajën me pelet, duhet të jetë oxhaku i izoluar.

Diametri minimal i oxhakut duhet të jetë Ø130mm.

### 4. Oxhaku i izoluar në të cilin lidhet kaldaja, duhet patjetër të jetë i pastruar para se të nisë funksionimi

Për të gjitha prishjet që shkaktohen nga mosmirëmbajtja e oxhakut, prodhuesi nuk i bartë pasojat. Intervali minimal e pastrimit të oxhakut është një herë në vit.

Oxhaku në formë katrore me dimensione të vogëla pengojnë funksionimin e mirë të kaldajës. Në oxhakun në të cilin lidhet kaldaja, nuk guxon të lidhet asnjë konsumator tjetër(kaldaja tjetër, stufa, kaloriferi apo ndonjë mjet tjetër i ngrohjes).

Lartësia minimale i oxhakut të jashtëm të izoluar është 3m nga vendi ku është lidhur me kaldajën.

### 5. Tensioni i rrjetit elektrik duhet të jetë stabil 230V ± 5% max

Në rast të mos plotësimit të këtij kushti, për ramjen dhe ngritjen periodike të tensionit, prodhuesi nuk bartë kurrfarë përgjegjësie në rast të prishjes së shkaktuar në kaldajë.


### 6. Pozicionimi i drejtë i kaldajës

Posa të pozicionohet kaldaja duhet të nivelizohet duke akorduar bazën.

Largësia minimale e kaldajës nga materialet jondezëse dhe vështirë të ndezshme, duhet të jetë 50cm(është e dëshirueshme të jetë distanca edhe më e madhe), dhe 100cm nga materialet lehtë të ndezshme!

Në rast të kalimit të qyngut nëpër materialin ndezës, siç është muri prej druri, nevojitet të bëhet izolimi i përshtatshëm i qyngut.

Nëse kaldaja vendoset në dysheme prej meteraili ndezës, nevojitet të ndërtohet mbajtësja prej materiali jondezës, me dimensione më të mëdha se dimensionet e kaldajës (së paku 20cm për pjesën e prapme dhe ato anësore dhe së paku 40cm për pjesën e përparme të kaldajës).



**Në rast se nuk janë respektuar disa nga kushtet e përmendura, kaldaja nuk guxon të lëshohet në funksionim!**